Strugë, fillon konferenca "Investo në të ardhmen"

Foto ilustruese

Strugë, 17 tetor - Maqedonia do të jetë nikoqir i konferencës së 4-të për mbështetjen e grave“Investo në të ardhmen” (Invest For The Future – IFTF), e cila do të zhvillohet nga dita e sotme e deri më 19 tetor.

Me këtë ngjarje, Maqedonia do të bëhet edhe zyrtarisht pjesë e rrjetit të vendeve të Evropës Juglindore dhe të Euroazisë, me zyrë dhe me koordinator të sajën.

Në konferencën që do të nisë pasditen e sotme, në Strugë, do të marrin pjesë 100 gra delegate nga gjithsej 15 vende, me numër të njëjtë të pjesëmarrësve: Maqedonia, Serbia, Kroacia, Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi.

Pjesëmarrëset e tjera, në cilësinë e mysafirëve, vijnë nga SHBA, Anglia, Polonia, Rumania, Turqia, Moldavia, Gruzia dhe Azerbejxhani.
Qëllimi i konferencës është që gratë, që vijnë nga fusha të ndryshme, t’i bashkëndajnë mes vete përvojat dhe performansat e tyre, me qëllim krijimin e një potenciali dhe rrjeti mentorësh, për mbështetjen e grave në biznes.

Programi i ngjarjes është titulluar “Talenti: imi, yti, yni” dhe mëton të krijojë një qasje të re të zhvillimit të konferencës, përmes prezantimit interaktiv të talenteve dhe përvojave të grave pjesëmarrëse, në temën e kreativitetit, udhëheqjes dhe liderizmit.